



Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen së vet të datës 22.04.2017 nxorri këto vendime:

VENDIMET 3-2017

Vendimi 3.1

Përmbyllja e kampionatit kombëtar 2016/2017

3.1.1 - Bordi i FAK vendosi që të gjithë pilotët pjesëmarrës në garë në etapën e fundit të kampionatit kombëtar (Albania Open), diciplina precizion që mbahet në Vlorë të përkrahen financiarisht me nga 20 EUR për shpenzimet udhëtimit.

3.1.2 - Bordi i FAK duke e bazuar në marrëveshjen në mes të FAK dhe Federatës Aeronautike Shqiptare (FASH) për organizim të përbashkët të kampionatit kombëtar, vendosi që të ndajë shumën prej 500 EUR për fondin e përbashkët të shpërblimeve për fituesit e kampionatit kombëtar.

Vendimi 3.2

Kampionati botëror - paragllajdzëm, precizion

3.2.1 - Bordi i FAK vendosi që lideri i ekipit dhe pilotët pjesëmarrës në garën e kampionatit botëror në paragllajdzëm, diciplina precision që mbahet në Vlorë, të pajisen me rekuizita (veshje) me shenja të shtetërore dhe të FAK.

Vendimi 3.3

Akreditimi i shkollës së fluturimeve të FAK

3.3.1 - Kryetari i bordit të FAK z. Shkëlqim Krasniqi raportoi për procesin e akreditimit nga AAC-ja të shkollës së fluturimeve të FAK. Me këtë rast ai theksoi se procesi është drejt përfundimit dhe se ka mbetur vetëm edhe një kusht i vetëm për akreditim të shkollës së FAK dhe kjo është sigurimi i një ligjeruesi të çertifikuar për meteorologji. Për plotësimin e këtij kushti bordi nxorri vendim dhe autorizoi kryetarin e bordit që të siguroj një kontratë mbi vepër në mes të FAK dhe meteorologun e licensuar Z. Sherif Gosalci.



Federata Aeronautike e Kosovës

Vendimi 3.4

Inicimi i procesit të akreditimit të qendrës për kontroll teknike të paragllajdëve

3.4.1 - Bordi i FAK nxorri vendim që të inicohet procedura e akreditimit nga AAC-ja të qendrës së FAK për kontrollim teknik të paragllajdëve. Bordi kërkoi nga sekretari i FAK që të analizoj rregulloret, kushtet dhe kërkesat e AAC-së për akreditim të kësaj qendre, si dhe të filloj me përgaditjen e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim për akreditim në AAC.

Vendimi 3.5

Pjesëmarrja e pilotëve të njëjës disiplinë në paragllajdzëm në garat ndërkombëtare të disiplinës tjetër

3.5.1 - Bordi i FAK analizoi dhe vendosi duke aprovuar kërkesën e komisionit për paragllajdzëm, disciplina distancë, që në rast se ekziston një kërkesë e arsyeshme nga komisioni përkatës që për hirë të rezultatit kombëtar të lejohet pjesëmarrja në gara ndërkombëtare të 1 (një) piloti që për disiplinë primare nuk e ka disiplinën në të cilën garohet. Kërkesa e këtij lloji duhet të adresohet në bord nga kryetarit të komisionit përkatës dhe të kërkohet aprovim.

Prishtinë, 26.04.2017

Shkelqim Krasniqi

Kryetar i bordit të FAK